



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e seancës s; 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2138/1 datë 09.06.2021, kundër autorit të panjohur, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka juridiksion për të vepruar sepse bëhet fjalë për pretendime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të organit tjetër kompetent që ka vepruar në rastin konkret.

Lënda me numër 12-2138/1 të datës 09.06.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, me datë 09.06.2021, është dorëzuar denoncim kundër një autori të panjohur dhe është formuar lënda me numër 12-2138/1 e datës 09.06.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se para llogaritjes së pensionit të pleqërisë, dikush ka intervenuar në evidencën e të dhënave të regjistruara të FSPIMV-së, me ç 'rast në vitin 1992 i janë konfiskuar 1.000.000 denarë. Ankuesi sqaron se mënyra se si i janë marrë këto para tregon për veprimtari kriminale dhe korruptive. Më tej ai thekson se ka parashtruar ankesa deri te organi i shkallës së dytë - Komisioni Shtetëror për Ankesa dhe në Gjykatën Administrative Shkup, por të njëjtat ankesa janë refuzuar si të parakohshme.

KSHPK pas shqyrtimit të pretendimeve, ka konstatuar se denoncimi ka të bëjë me pretendimet që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të organit tjetër kompetent, i cili ka vepruar në këtë rast, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka juridiksion për të vepruar dhe ka vendosur si në dispozitë e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M, bashkëpunëtor i lartë

Miratoi: SPD, anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Нёнкрyетар
Goran Trpenoski

